



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
ГЈУКТА КУШТЕТУЕСЕ
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 maj 2014
Nr.ref.:RK578/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI145/13

Parashtrues

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të ankesave të Dhomës së Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr. AC-II-12-0120, të 20 qershorit 2013

Parashtruesi gjithashtu kërkon vendosjen e masës së përkohshme

GJYKATA KUSHTETUUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), përfaqësuar nga z. Gani Ademi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kérkesës e konteston Aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS), për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: AKP), nr. AC-II-12-0120, të 20 qershorit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit më 24 qershor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegit të ankesave të DHPGJS nr. AC-II-12-0120, të 20 qershorit 2013.
4. Parashtruesi pretendon se Aktvendimi i Kolegit të ankesave të DHPGJS për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ka shkelur të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 102 paragrafi 3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, si dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e dhe Liritë Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).
5. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës të vendosë masë të përkohshme që të “*ndalohet ekzekutimi i aktgjykimit AC-H-12-0120 i datës 20.6.2013 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, derisa gjykata të vendosë në mënyrë meritore, sipas kérkesës së parashtruar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në mbështetje të nenit 55, pika 4, e Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës*”.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 në lidhje me nenin 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykates Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

7. Më 10 shtator 2013, parashtruesi e dorëzoi kérkesën në Gjykatë.
8. Më 24 shtator 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI145/13, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI145/13, caktoi Kolegin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 6 nëntor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kérkesës dhe DHPGJS për çështje që lidhen me AKP-në për regjistrimin e kérkesës me nr. KI145/13.

10. Më 24 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjiqtarit rapportues, Kolegji shqyrtues i kësaj Gjykate i paraqiti rekomandimin Gjykatës për papranueshmërinë e kërkesës.
11. Njëkohësisht, Kolegji shqyrtues i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë që të refuzojë kërkesën e parashtruesit për vendosjen e masës së përkohshme, me arsyetimin se i njëjtë nuk ka bashkëngjitur asnjë dëshmi të bindshme që do të arsyetonte vendosjen e masës së përkohshme si të domosdoshme në mënyrë që të shmanget ndonjë dëm i pariparueshëm ose dëshmi se një masë e tillë është në interesin publik.

Përbledhja e fakteve

12. Ngastrën kadastrale nr. 1976 prej 1.19,00 ha, regjistruar në fletën poseduese nr. 144 ZK Lladrovc, Sokol M. Bibaj (në tekstin e mëtejmë: S. B.) e kishte trashëguar, nga paraardhësit e tij. Që nga viti 1963, ngastra kadastrale e lartekur është regjistruar në librat kadastrale në pronësi të S. B., kur Kuvendit i Komunës në Malishevë, përkatësisht Komiteti Administrativ, me Vendimin nr. 1721 të 25 dhjetorit 1963, shpalli S. B. usurpues arbitrar të ngastrës së lartpërmendur, dhe në bazë të atij vendimi S. B. fshihet nga librat publikë kadastralë të pronës kontestuese.
13. Në një datë të pacaktuar, ndërmarrja "MIRUSHA" nga Malisheva, ishte regjistruar në librat kadastralë si pronar i ngastrës kontestuese.
14. Më 15 gusht 1969, me Vendimin nr. 9835, Komiteti Administrativ i Kuvendit të Komunës në Suharekë (passadhësi ligjor Kuvendi i Komunës në Malishevë), duke vendosur lidhur me ankesën e S. B., paraqitur kundër Aktvendimit nr. 1721 të 25 dhjetorit 1963, anuloi Aktvendimin nr. 1721, me të cilin S. B. është shpallur usurpator arbitrar i pronës së paluajtshme të lartekur, dhe në këtë mënyrë ia kishte njojur të drejtën e pronësisë S. B. mbi pronën e paluajtshme.
15. Më 28 mars 2001, S. B. përkatësisht përfaqësuesi i tij ligjor paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Malishevë për konfirmimin e pronësisë kundër të paditurit të parë, Komuna e Malishevës dhe të paditurit të dytë, ndërmarrja bujqësore „MIRUSHA“ nga Malisheva, duke kërkuar konfirmimin e pronësisë mbi ngastrën kadastrale nr. 1976 prej 1.19,00 ha, të regjistruar në fletën poseduese nr. 144 ZK Lladrovc. Parashtruesi, përkatësisht AKP-ja pretendon se është pronare e pronës së kontestuar, sipas librave kadastralë të ndërmarrjes bujqësore „MIRUSHA“ nga Malisheva. Parashtruesi në padinë e tij ishte dekluaruar si përfaqësues ligjor i ndërmarrjes bujqësore „MIRUSHA“ nga Malisheva.
16. Më 20 prill 2001, me Aktvendimin C. nr. 28/01, Kuvendi Komunal në Malishevë ishte shpallur jokompetent.
17. Më 25 nëntor 2005, DHPGJS me Aktvendimin nr. SCC-05-0010 për çështje që lidhen me AKP-në, duke vendosur sipas padisë së S. B., nxori një Aktgjykim, me të cilin padia ishte përcjellë në Gjykatën Komunale në Malishevë.

18. Më 13 prill 2006, me Aktgjykimin C. nr. 20/2006, Gjykata Komunale në Malishevë, aprovoi kërkesëpadinë e S. B. si të bazuar dhe vërtetoi se S. B. ishte pronar i ngastrës kadastrale nr. 134 dhe 797 në sipërfaqe të përgjithshme prej 1.19,00 ha, e regjistruar në fletën poseduese nr. 62 ZK Lladrovci, pérderisa Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë e obligon KK e Malishevës ta regjistrojë ngastrën e lartcekur në librat kadastralë në emër të S. B.
 19. Më 13 qershor 2006, parashtruesi dhe Komuna e Malishevës ushtruan ankesë kundër Aktgjykimit C. nr. 20/2006 të Gjykatës Komunale në Malishevë.
 20. Më 1 shtator 2006, me Aktvendimin C. nr. 20/2006, Gjykata Komunale në Malishevë, e përmirësoi Aktgjykimin e 13 prill 2006, C. nr. 20/2006, në atë mënyrë që e ndryshoi paragrin 2 të dispozitivit, ashtu që në vend të ngastrës kadastrale nr. 134 dhe 797 shënoi ngastrën nr. 1976, dhe në vend të listës poseduese nr. 62 shënoi listën nr. 144.
 21. Më 16 maj 2007, me Aktvendimin SCA-06-006, trupi gjykues i DHPGJS, duke vendosur sipas ankesës së parashtruesit dhe Komunës së Malishevës, e aprovoi ankesën, e prishi Aktgjykimin C. nr. 20/2006 të 13 prillit 2006 të Gjykatës Komunale në Malishevë dhe e ktheu lëndën në gjykatën e shkallës së parë përigjykim.
 22. Më 4 dhjetor 2009, Gjykata Komunale në Malishevë nxori Aktgjykimin C. nr. 149/2007, me të cilin e aprovoi kërkesëpadinë e S. B. si të bazuar dhe vërtetoi se S. B. është pronar i ngastrës kadastrale nr. 1976, e regjistruar në fletën poseduese nr. 144 ZK Lladrovci. Me këtë aktgjykim, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë e KK të Malishevës ishte e obliguar ta regjistrojë parcelën e lartcekur në librat kadastralë në emër të S. B. Ky aktgjykim i ishte dorëzuar parashtruesit më 30 dhjetor 2009.
 23. Më 1 mars 2010, parashtruesi ushtroi ankesë në DHPGJS kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Malishevë C. nr. 149/2007 të 4 dhjetorit 2009.
 24. Më 20 qershor 2013, me Aktvendimin AC-II.-12-0120, Koleksi i ankesave të DHPGJS, e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Malishevë C. nr. 149/2007, si të paafatshme, duke arsyetuar që:
- “E paditura e kishte pranuar Aktgjykimin e kundërshtuar më 30 dhjetor 2009, ndërsa kishte parashtruar ankesë kundër këtij Aktgjykimi më 01 mars 2010, që do të thotë 61 ditë, pasi që e paditura e kishte pranuar aktgjykimin e kundërshtuar. Në bazë të nenit 9.5 të Rreg. Së UNMIK-ut 2008/4, i zbatueshëm në kohën e marrjes së aktgjykimit të kundërshtuar dhe në kohën e parashtrimit të ankesës, “brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e Vendimit, pala mund të paraqes ankesë në Panelin e Apelit përrishqyrtim të Vendimit të tillë”.*
25. Më 25 qershor 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesë për korrigimin e llogaritjes së afatit në Aktvendimin e Kolegit të ankesave të DHPGJS.

“Agjencia Kosovare e Privatizimit konsideron se Kolegji i Apelit e ka llogaritur gabimisht afatin e parashtrimit të ankesës së AKP-së ndaj aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Malishevë me numër C. nr. 149/07 me 04.12.2009, i cili është në kundërshtim me dispozitën e nenit 20.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6, si dhe me kundërshtim me këshillën juridike të dhënë me aktgjykim C. nr. 149/07 te datës 04.12.2009”.

26. Më 27 gusht 2013, me Aktvendimin AC-II-12-0120, Kolegji i ankesave e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme, me arsyetim:

“Kur është hedhur ankesa si e paafatshme, përllogaritja e afatit është bërë konform Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, si akt më i lartë në hierarkinë e akteve ligjore, e jo të Udhëzimit Administrativ 2008/6, që është një akt më i ulët se rregullorja në fjalë. Sipas kësaj rregulloreje, afati ligjor për parashtrimin e ankesës është 30 ditë, ndërsa ankesa ishte parashtruar pas këtij afati.

Është fakt i pamohueshëm se kjo kompetencë për gjykim në shkallë të parë ishte referuar nga Dhomë e Posaqme, në Gjykatën Komunale në Malishevë. Me bartje të kompetencës, Dhomë e bartë atë në suaza të shtrirjes së kompetencës që ka vetë, e që e përcakton Rregullorja 2008/4. Në bazë të kësaj rregulloreje, afati për ankesë është 30 ditë dhe nuk mund t'i bartë gjykatave tjera me shumë kompetencë, që do të thotë edhe afatin ligjor prej 30 ditësh. Udhëzimi Administrativ 2008/6 vërtet përcakton një afat pre dy muaj ditësh, kundër vendimeve të gjykatave komunale, por, kjo kompetencë ishte e bartur nga Dhomë, e Dhomë nuk mund të bartë më shumë kompetencë se sa ka vetë. Nën dy, ai afat për ankesë është në kundërshtim me afatin prej 30 ditësh, të përcaktuar me rregullore, e cila sipas kritereve të aplikueshmërisë është në nivelin e ligjit, ndërsa udhëzimi administrativ është një akt nënligjor i cili nuk mund të jetë në kundërshtim me ligjin, në këtë rast rregulloren”.

Pretendimet e parashtruesit

27. Parashtruesi pretendon se autoritetet gjyqësore, përkatësisht Kolegji i ankesave të DHPGJS (Aktvendimet ASC-II-12-0120 i 20 qershorit 2013 dhe AC-II-12-0120 i 27 gushtit 2013) kishin shkelur të drejtat nga neni 102.3 Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe të drejtat nga neni 6 i KEDNJ-së.
28. Parashtruesi pretendon se:

“Aktvendimi AC-II-12-0120 i datës 20.6.1020, si dhe aktvendimi AC-II-12-0120 janë nxjerrë me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale. Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaqme gabimisht e ka aplikuar nenin 9.5 të RREG/UNMIK-ut 2008/4 për refuzimin e ankesës së AKP-së kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Malishevë C. nr. 149/07 të datës 04.9.2009 si të papranueshme. Kjo, nga fakti se me këtë dispozitë parashihet afati 30 ditor për parashtrimin e ankesës në Panelin e Apelit ndaj vendimeve të marra nga Paneli Gjykues i Dhomës së Posaqme”.

29. Parashtruesi në veçanti pretendon se:

*“Aktvendimi AC-II-12-0120 përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të përcaktuar me nenin 160, lidhur me nenin 169 të LPK-së, Ligji nr. 03/L-006. Kjo, nga fakti se në këshillën juridike të dhënë në aktgjykimin C. nr. 149/2007 të datës 04.12.2009, gjykata ka përcaktuar afatin 60 ditor për apelimin e aktgjykimit. Neni 169.1 I LPK-së përcakton se: **Gjykata është e lidhur për aktgjykimin e saj që nga momenti i dhënies së tij**. Ndërsa, aktgjykimi vepron ndaj palës nga dita e pranimit. Andaj, pala nuk mund të dëmtohet apo të privohet nga e drejta e garantuar me ligj, për shkak të shkeljes së ligjit apo interpretimin të gabuar nga gjykata. Nga shkresat e lendes nuk është kontestues fakti se ankesa e AKP-së është paraqitur brenda afatit të dhënë në këshillën juridike për apelim dhe në përputhje me ligjin ne fuqi për apelimin e aktgjykimit”.*

30. Parashtruesi pretendon më tej se:

“Përmes kësaj kërkesë Agjencia Kosovare e Privatizimit kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës të marrë aktgjykim me të cilin do ta shpallë kërkesën e pranueshme, ti anuloj aktgjykimet AC-II-12-0120 të datës 20.6.2013 dhe AC-II-12-0120 të date 27.8.2013, të lëshuara nga Doma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës”.

31. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të:

“Aprovohet propozimi për caktimin e masës së përkohshme, ndalohet ekzekutimi i aktgjykimit AC-II-12-0120 i datës 20.6.2013 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, derisa gjykata të vendosë në mënyrë meritore, sipas kërkesës së parashtruar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në mbështetje të nenit 55, pika 4, e Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese te Kosovës”.

Pranueshmëria e kërkesës

32. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse ai i ka përbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore.
33. Në këtë rast, Gjykata i referohet nenit 113.7 në lidhje me nenin 21 paragrafi 4 të Kushtetutës, që parasheh:

“113.7 Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

“21.4 Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.

34. Pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe argumenteve të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi kryesisht ankohet kundër vendimit të Kolegjit të ankesave të DHPGJS-së, me të cilin ankesa e parashtruesit hidhet poshtë si e paafatshme. Parashtruesi në ankesën e tij ka kërkuar nga Kolegji i ankesave të DHPGJS-së që ta korrigoj llogaritjen në aktvendim. Agjencia Kosovare e Privatizimit vlerëson se Kolegji i ankesave ka llogaritur gabimisht afatin e fundit për paraqitjen e ankesës nga AKP-ja kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Malishevë.
35. Gjykata rikujton se një nga kriteret e pranueshmërisë së kërkesës është që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar, në mënyrë që Gjykata të shqyrtojë meritat e kërkesës.
36. Lidhur me këtë, dispozitat e rregullit 36 (1) c) dhe rregullit 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, parashohin:
- “(1) *Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
- [...]
- c) *kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.*
- (2) *Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
- b) *faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*
- c) *kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
37. Sa i përket pretendimit të parashtruesit se “*Kolegji i ankesave të DHPGJS-së kishte vendosur në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e zbatueshme të Republikës së Kosovës*,” Gjykata gjen se vendimi i Kolegjit të ankesave të Dhomës së Posaçme nuk përmban shkelje thelbësore të të drejtave kushtetuese, sepse parashtruesi nuk kishte shpjeguar pse dhe si aktvendimi i Kolegjit të ankesave ishte në kundërshtim me dispozitat kushtetuese.
38. Arsyetimi i Aktvendimit të Kolegjit të ankesave të DHPGJS-së, të cituar në paragrafin 24 të këtij raporti është kryesisht i bazuar në parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor, ku gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit, duke mbështetur arsyetimin e vendimit në pajtim me praktikën gjyqësore lidhur me rastet e natyrës analoge.
39. Gjykata rikujton se rasti duhet të ndërtohet në bazë të argumentit kushtetues në mënyrë që Gjykata të mund të intervenojë.
40. Gjykata vëren se baza e ankesës së parashtruesit të kërkesës përmban pretendime lidhur me shkeljet thelbësore të dispozitave të zbatueshme ligjore dhe shkelje të procedurës kontestimore.
41. Gjykata thekson se, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktave ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga

gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

42. Gjykata ripërsërit se nuk është detyrë e saj të vlerësojë ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimeve të nxjerra nga gjykatat e rregullta, përveç nëse ka prova bindëse se vendimet e tillë janë marrë në mënyrë qartazi të padrejtë dhe të paqartë.
43. Detyrë e Gjykatës, përkitazi me shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese, është të analizojë dhe vlerësojë nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, kanë qenë të drejta dhe në përputhje me mbrojtjen e dhënë shprehimisht me Kushtetutë. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
44. Përveç kësaj, parashtruesi i kérkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese, të përmendura në kérkesë, përbën shkelje të të drejtave kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kérkesës, nr. 53363/99, të 31 majit 2005. Parashtruesi nuk saktëson se si nenet 31 dhe 102.3 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së e mbështesin pretendimin e tij, siç kërkon me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.
45. Për më tepër, Gjykata nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse, të mbajtura në Gjykatën Komunale dhe në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, kanë qenë në ndonjë mënyrë, të padrejta apo arbitrarë (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kérkesës, nr. 17064/ 06, të 30 qershorit 2009). Mbështetja e parashtruesit në këshillën e Gjykatës Komunale lidhur me kohëzgjatjen e afatit ligjor brenda të cilit një ankesë e mundshme mund të dorëzohet nuk mund të shërbejë si zëvendësim për përputhshmëri me një dispozitë të qartë ligjore. Një dispozitë e tillë është dhënë nga ligjvënësi për qëllim të sigurisë ligjore duke i dhënë kështu mundësi palëve që të njohin të drejtat e tyre për ankesë dhe kohëzgjatjen e afateve ligjore për dorëzimin e ankesës.
46. Gjykata më tutje vlerëson se ishte detyrë e parashtruesit të dijë afatin përfundimtar për të parashtruar ankesë. Duke u mbështetur në këshillën e gabuar për mjetin juridik nga ana e Gjykatës Komunale, ai ka dështuar të ushtrojë kujdes të nevojshëm dhe nuk mund të tregojë argumente të arsyeshme që do të falnin dështimin për të respektuar afatin e saktë përfundimtar të paraparë me dispozitën e duhur ligjore.
47. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se kérkesa e parashtruesit nuk i plotëson kriteret për pranueshmëri, sepse parashtruesi i kérkesës nuk ka arritur të tregojë se vendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat dhe liritë e tij, të garantuara me Kushtetutë.

48. Si përbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit, në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, është qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht, e papranueshme.

Kërkesa për masë të përkohshme

49. Neni 27 i Ligjit, dhe në veçanti rregulli 54 (1) i Rregullores së punës, parashohin se "në çfarëdo kohe, përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme".
50. Megjithatë, duke marrë parasysh se kërkesa është deklaruar e papranueshme, parashtruesi, në pajtim me rregullin 54 (1) të Rregullores së punës, nuk ka të drejtë të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme.
51. Përveç kësaj, parashtruesi vetëm ka kërkuar nga Gjykata të vendosë masën e përkohshme dhe nuk kishte ofruar argumente shtesë ose dokumente relevante në kërkesën e tij.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, rregullit 36 (2) b) dhe d), dhe rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, më 24 mars 2014, njëzëri

VENDOS

- I. **TA DEKLAROJË** kërkesën të papranueshme;
- II. **REFUZOHET** kërkesa për masë të përkohshme;
- III. Ky Vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

